

BETIM MUÇO

8SH-L

M 98

# KRUGËVE TË ATDHEUT



891.983-1

M 98

S

BETIM MUÇO

# RRUGEVE TE ATDHEUT

(Poezi)

~~45244~~

13669

LITERA E SHPE<sup>SHPE</sup>TË

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## V A R G J E V E

S'ju hodha juve fishekzare  
Në qiellin e lavdisë,  
Un' dhe këtu jam një ushtar  
Në front të poezisë.

Do shtrihi fushave me shinat,  
Oxhaqeve do ngjiti,  
Punëtorve nëpër kantiere  
Ju djersën do t'u fshini.

Do mbini tokave pjellore,  
Ugareve të gjerë  
T'ju korrë bujku tok me drithin  
Fushatave në verë.

S'do t'ju dërgoj të pini birrë  
Diku me Uollt Uitmanë,  
Në këto shkrepa ju s'u lindët  
Për shpendët shtegtarë.

Do fluturoni mbi atdheun  
S'do shuhi si jehonë,  
Sgalemë dallgëve të jetës  
Do mbeteni gjithmonë.

## MIRUPAFSHIM

Shinat shpleksen rrrotave si lëmshi,  
Kënga përtej gjoksesh fluturon;  
Mirupafshim, shokë, mirupafshim,  
Ne po shkojm' të parët në aksion!

Do na shihni fushash edhe malesh,  
Do ja ndjeni zërin forcës sonë...  
Kuqëlojnë flamujt' e aksionit  
Nga Bistrica deri në Valbonë.

Do na rrabin breshëri dhe era,  
Shiu dhe kamzhikët e furtunës,  
Por s'do reshtin këngët aksioniste  
Në çdo skaj të fonteve të punës.

Kështu jemi ne, porsi baroti,  
Plot me muskuj, ëndrra, energji  
Dhe e duam, pa kufi e duam,  
Tokëzën e dashur Shqipëri.

Rrugët shpleksen rrrotave si lëmshi,  
Kënga përtej gjoksesh fluturon;  
Mirupafshim, shokë, mirupafshim,  
Ne po shkojm' të parët në aksion!

## PËRSHËNDETJE SHOKËVE

Të përshëndes, armata e rinisë,  
Falang' e re e zemrave të zjarrita,  
Vërs huam ne nën thirrjen e Partisë,  
T'i bëjm' agimet tona më të arta.

Ky vendi yn', i lashtë dhe i bukur,  
Një t'ardhme më të bukur po ndërton;  
Ndaj sot kudo boria jon' e sulmit  
Solemne, madhiështore po ushton.

Ne dim' të dashurojmë dhe të qeshim,  
Të ëndërrojmë majat më të larta,  
Por dim' si burra, vështirësitë t'i ndeshim,  
Të shpartallojmë pengesa dhe blokada.

Si det i thellë — mundësitë tona,  
Për lodhjen brezi ynë s'do t'ja dijë:  
Jan' çelsi më i sigurt këta muskuj  
I s'ardhmes komuniste që do ndrijë.

Të përshëndes, armata e rinisë,  
Falanga e çeliktë zemërjarr,  
Un' ja arrita kulmin lumtërisë,  
Në vij' të sulmit sot të jém ushtar.

## KËNGA E MËNGJESEVE

Nga kampi u nisëm me vrull të pashuar  
Me rrezet e para të diellit,  
Flamur buzëqeshjet duke i shpalosur  
Në sfondin e kaltër të qiellit.

Në rrugën me pluhur, kalojnë brigadat  
Me kazmat, si armët, në sup,  
Gavetat me bukë, paguret granata,  
Dhe kënga që gjumin ta shkund.

O bashkatdhetarë, o shoqe, o shokë,  
Kudo mbi të shtrënjin atdhe,  
Un' jam kaq krenar që po nisem pa gdhirë,  
Në vendin e punës, atje.

Me djersë ta mpleksësh ti gazin e jetës  
Dhe kokën me nder ta mbash lart.  
Si shkrepse t'i thyesh ti normat në punë  
Me shokët e tjerë përqark.

Të shkosh si ushtar përmbi tokën amtare,  
Ku vetja të ngjan si Atllas,  
Kur mbart përmbi supe kaq èndrra vigane,  
Që kazma rreth teje përhap.

## K R E N A R I

Shiko këtej, në kodrat përbri detit,  
Lëshon zjarr kazma që mban dora jonë;  
Në kallot që forcuan këtò duar  
Ndër mend do sjellim ne aksionin tonë.

Kjo tokë me lapidarë dekoruar,  
Na thirri sot pér punë të mëdha,  
Ndaj në tarracat, brigjeve të kaltër,  
Të gjelbërojnë ullinjtë sa më la.

Dhe zemra rreh me zjarr ndër kraharore,  
Me forcë mbi shkëmbinj kazma qëllon,  
Po, shokë, jeta është madhështore,  
Kur ideali ne na frymëzon.

Të detit dallgë këngë do këndoijnë,  
Këtu nën gjelbërimin e ullinjve,  
Do t'i këndoijnë këngë djersës sonë  
Dhe miqësisë së madhe të të rinjve.

## O KODRA

O kodra, që drithin s'e njihnit më parë,  
Ku drita e diellit mes shkurresh humbiste,  
U pranuat ushtarë në armatën e madhe,  
Në armatën e re komuniste.

I përkisni së ardhmes ju, toka djerrina,  
Ku këng' e rinisë krenare buçet,  
Dikur do të vijmë të korrim prodhimin,  
Kur gruri të ngjajë si vala në det.

Poemë e shkruar në vargje tarracash  
Mbi faqet e pjerrta të kodrave;  
A e mendonit, o vende të egra,  
Se do t'ju vinte dhe ju koha?

Muskujt i veshim me tylin e djersës,  
Lirinë i japim pjellorisë së tokës;  
Nga kodrat e mbjella me farën e s'ardhmes  
Buzëqeshjen e madhe i dhurojmë botës.

## GJITH' E DUAN KOMANDANTIN...

Gjith' e duan komandantin,  
Ësht' m'i miri djalë,  
Ndonse s'bën në pun' lëshime  
Dhe të rreptë ka fjalën.

Kur na nxehet me ndonjërin,  
Me duart e forta,  
Si rrufe vetëtin kazmën,  
Thua tundet kodra.

Vajzat qeshin dhe jo rrallë  
Syt' andej i hedhin  
— Forca, — buçet komandanti, —  
Të arrimë ledhin.

— Forca, shokë, se ky ritëm  
Fare s'na nderon.  
Lefteri, tundu, të shkretën!  
Ç'ke që nusëron?

— Ti çfar' ke gjithmonë me mua,  
S'gjete ndonjë tjeter? —  
Ajo kthehet zemëruar,  
Shoqet tutje qeshin.

Komandanti skuqet flakë,  
S'gjen të thotë një fjalë,  
E lëshon kazmën për tokë,  
Shkon përtej ngadalë.

Që së largu zëri tia  
Dëgjohet pas pakë.  
Gjith' e duan komandantin  
Ësht' m'i miri djalë.

## PËRSHËNDETJE

Sot shpërthyem ne minat e para,  
Ushëtuan shkëmbinjt' anembanë,  
Tundën malet qeleshet e bardha:  
«Pun' e mbarë, o shokë» na thanë.

E rrëmbyen jehonën luginat,  
Si flamur e shpalosën ato,  
«Përshëndetje ju, prindër të dashur,  
Përshëndetje ju, shokë, kudo».

Kilometrat e shumta do zgjaten,  
Do të ndihen gumzhitje maqine  
Dhe do ngjajë kjo rrugë malore  
Si një fjongo kurorës alpine.

Udhëtar, kësaj rruge të largët,  
Që nga Hoti gjer tej në Vermosh,  
Në çdo ngjitje a kthesë zikzake  
Vrullin tonë aty do shikosh.

Nuk u mburrëm se bëm' gjë të madhe,  
Veç detyrën ne bëmë këtej.  
Një arter ne i shtuam atdheut  
Që veç gjak komunizmi të rrjedhë.

## SHOKUT TË LARGËT

O shoku im i largët vietnamez,  
Të përshëndet nga Shqipëria mike  
Një bir i denjë i popullit me besë,  
Që s'i përfill largësitë gjeografike.

Ne këtu, në aksionin e rinisë  
Treqind për qind e kryem normën sot,  
Si solidarë të luftës së lirisë,  
Si solidarë të luftës suaj, shok.

Si mundim ne rrëke mos derdhim djersën,  
Kur gjakun tuaj derdhni ju rrëke?  
Çdo çast mendimi ynë, si shigjetë,  
Në vendin tuaj fluturon, atje.

Pas jush qëndron rini' e gjithë botës,  
Qëndron mur'i çeliktë i popujve.  
Ja shkrepni agresorit mu në zemër  
Ju pushkën e hakmarrjes dhe për ne.

Dhe përmbi tokën tuaj hercike  
Do shkrepë djell'i fitores një mëngjes;  
Ahore tok do shkojmë në aksione,  
O shoku im i largët vietnamez.

## KËNDO, POET!

Në grykën e thepisur, midis majash,  
Si katarakt i bardhë derdhen retë,  
Agimi hapësirën ndezi flakë,  
Pa nisën këngën kazmat dhe varetë.

Mbaj nëpër duar një vare të rëndë,  
Godas mbi barominën e çeliktë  
Dhe, nga goditjet, më shpërthejnë vargjet  
Shkëndija nga mendimet poetikë.

«Kështu të dua» vetes i them dendur,  
«Që t'i habitësh njerzit me fuqinë  
Dhe jo ta dredhësh zërin ashtu ëmbël,  
Të cicërosh, poet, si kanarinë.

T'ja marrësh këngës gjoks më gjoks me shkëmbin,  
Aty, mes frymëmarrjes së djersitur,  
Me krenari të shohësh prapa rrugën  
Me fillin ar të djersës të qëndisur.

Dhe nesër, kur të vlojë eksplozivi,  
Në erë të fluturojnë metrokubet,

Ti të shikosh, djersitur mbi varenë,  
Se si thërmohet shkëmbi dhe përkulet.

Këndo, poet, me muskujt e fuqishëm  
Godit mbi barominën e çeliktë,  
Le të shpërthejnë vargjet nëpër botë  
Shkëndija nga mendimet poetikë».

## VARGJE KRENARE

Një copë qiel tendosur mes shkëmbinjve,  
Ku të kristaltë Cemi ujin bie,  
S'do t'ju harroj, o vise kreshtëashpra,  
Ju gurra të pashtershme poezie.

Shaluar përmbi vitet do na sjellin  
Në këto anë kohët që do vijnë  
Dhe, duke udhëtar kësaj rruge,  
Do të kujtojmë ne ather' rininë.

Kështu, pra, shok, luftuam me shkëmbinjtë  
Çdo metër sa pengesa kemi prapsur,  
Që komunizmi porsi diell të ndrisë  
Përmbi çdo shkrep të tokës kaq të dashur.

Prandaj nuk do t'i shohim me keqardhje  
Ne vitet shkuar sulmesh ndër beteja,  
Dhe flokëzbardhur ne via e sulmit  
Kudo do jemi fronteve të reja.

45847 / 3669

BIBLIOTEKA E SHTESË  
BULGARISKE

## MIRUPAFSHIM, O VENDE TË SHTRENJTA

Mirupafshim, o vende të shtrenjta,  
Ku s'shteroi entuziazmi i punës;  
Ja, po kthejmë; mbi supe kujtimet  
Mbeten pas kilometrat e rrugës.

Shih si zgjatet kjo rrugë malore,  
Si një tingull pa fund çiftelie,  
Ne do mbesim në këngët malsore  
Si simbole të gjalla krenarie.

Dhe kudo që të jemi shpërndarë,  
Në çdo kënd të atdheut të dashur,  
Do të ndjejmë borin' e maqinës  
Nëpër rrugën që ne kemi hapur.

Prandaj jemi dhe ne kaq krenarë  
Duke zbritur këtej prej malsisë,  
Sepse sollëm, në botën malsore,  
Të fuqishmet ide të Partisë.

## KTHIM KRENAR

Fluturoni, këngë, si pëllumba.  
Ne po vijmë nga aksioni, shokë,  
Përshëndesim mijra njerëz, turma;  
Jo kapelet, zemrat mbajmë në dorë.

Sjellim «S»ët e kuqe nëpër gjokse,  
Romantikën tonë aksioniste,  
Zëmrat e çelikta farkëtuar  
Në të madhen farkë komuniste;

Po ju sjellim buzëqeshjet tona,  
Lule të agimeve që vijnë,  
Ja, atje, ku djersa derdhet lumë,  
Ne e shohim të jetës lavdinë.

Ju, të dashur shokë vullnetarë  
Dhe ju që na prisni krahëhapur  
Tok gjithmonë do t'i sulmojmë vitet,  
Njerzit në aksione s'kan' të mplakur.

Jetës ne do t'ja rrëmbejmë gëzimet,  
Ja, me këta muskuj ngjyrë bronxi.  
Ësht' armat'e sulmit për të ardhmen,  
Kjo që nëpër rrugë sot shikoni.

Fluturoni, këngë, si pëllumbा.  
Ne po vijmë nga aksioni, shokë,  
Si vullkane na shpërthejnë gjokset  
E shpérndajn' gëzimin përmbi tokë.

# KËNGËT E RRUGËS

## R R U G È T

Rrugët ndahen, rrugët prap' bashkohen,  
Lart kurora plepash mbi to përqafohen;

Era tundet si shami e madhe,  
Sikur transmeton me radhë puthje ndarjesh.

Gruri kallirëndë, ndanë rrugës,  
Këndon madhështoren melodi të bukës.

Dhe maqina nisen edhe vijnë  
Porsi gjak i ri, ndër dej, për Shqipërinë.

Rrugët ndahen, rrugët prap' bashkohen,  
Lart kurora plepash mbi to përqafohen.

## NË AUTOBUS

Rrjetë e shiut tundet nëpër rrugë,  
Pasqyrohen dritat mbi asfalt,  
Përmbi xham i qeshur mbështes ballin  
N'autobusin «Bankë-Kombinat».

Mijra sy gazmorë, nën ombrella,  
Po nxitojnë rrugëve të lara.  
C'lumtëri, o miq, kur sjell ndër mend  
Vitet që na presin ne përpara!

C'ndjenj'e madhe zemrën ta pushton,  
Kur i afërt midis njerzish je,  
Kur shikon gëzimin njerëzor  
Që shkëlqen si dielli mbi atdhe.

Të mëdha jan' dashuritë tona  
Dhe detyrat tona të mëdha;  
Ne këtu ndërtojmë komunizmin,  
Më të mrekullueshmen kala.

Prandaj s'pyesim as për shi as vjeshtë,  
Mbjellim buzëqeshje mbi asfalt,  
Prandaj lindi dhe kjo këng' e thjeshtë,  
N'autobusin «Bankë-Kombinat».

## MOTIV STUDENTESK

Shiu bie në rrugë i butë,  
Mbi ombrellat e shpeshta godet,  
Sa e shkurtër të duket kjo rrugë,  
Nga konvikt kur zbret në qytet!

Do bashkohesh me turmën e qeshur  
Edhe zëra gazmorë do ndjesh,  
Ndoshta prap atë vajzën e qeshur  
Midis njerzish ti mundet ta gjesh.

Derivatet braktise për sonte...  
Do shkëlqejnë neonet mbi ty;  
Do kalosh ti i qeshur mes rrugësh,  
Çdo njeri do ta shohësh në sy.

Shiu bie në rrugë i butë,  
Mbi ombrellat e shpeshta godet,  
Sa e shkurtër të duket kjo rrugë,  
Kur të shtunën ti zbret në qytet.

## NJË VAJZE

Më qëndron te dritarja e lartë,  
Hapi im kur në rrugë troket  
Dhe këtu kryqëzohen shikimet,  
Vetëtima të zjarcta mbi det.

Eh, sa gjëra që kam për të thënë,  
Kur një ditë ti pranë do jesh,  
Do të njihesh me këngët e mia  
Dhe goditjet e zemrës do ndjesh.

Me guxim do të ngrem' ëndrrat tonë  
Për pranverën e jetës-rini,  
Do të shkojmë të dy, mbi atdheun  
Do të ngremë qytete të rinj.

Ne na grishin sirena uzinash,  
Këng' e fshatit në fushë, atje,  
Dhe asnjëri, moj vajzë e dashur,  
S'do të ndjehet i lumtur sa ne.

## POEMA E BUKËS

Do t'ju flas pér poemën e bukës,  
Pér poetët që thurin atë:  
Ata kthehen të lodhur mes fushës,  
Kënga rritet sa vjen gjithënëjë.

Gruri shtrihet pérpara i gjelbër  
Kallz'i blertë arrin gjer në gju,  
Dhe këtu nis poema e madhe,  
Nis poema e jetës këtu.

Përmbi çizmet e rënda me baltë,  
Në mes grurit drejtori kalon;  
Sa të gjera jan' tokat e fermës  
Që i gjelbërti det i mbulon!

Gjelbërimi i madh të mbyt sytë,  
Përmbi kallza kur dora rrëshqet,  
Ai ndoshta këtu e ndjen veten  
Si në mes të fëmijve të vet.

Mos mendoni se s'ësht' poetike  
Që pér bukën në vargje të flas,  
Buka është një armë jetike,  
Që të fortë na bën në çdo çast.

## PËR MIQËSINË

Ne i njohim rrugët përmbi tokë,  
Çdo stuhie bashk' i bëjmë ballë.  
A ka më të madhërishme shokë  
Se sa ndjenja që na lidh ne vallë?

Këtu në mes duarsh të fuqishme  
Bluhet si në mokër pabesia  
Dhe nxjerr krye lulja më e hijshme,  
Lulja më e bukur, miqësia.

Ajo s'ka nevoj' për lavdrime,  
Përbetime, lot sentimentalë  
Dora kur shtrëngon dorën e shokut  
Është poezia që s'do fjalë.

Dhe do mbetet përgjithmon' e madhe,  
Përgjithmon' e thellë, e paanë  
Si një shteg që lidh dy vargje malesh,  
Si një det që lidh dy oqeanë.

## FJALA IME

Bir i lindur prindësh komunistë,  
Vetëm komunizmit i përkas.  
Sot nuk matet koha më me orë,  
Me revolucion e un' e mas.

Grumbullim kantieresh dhe oxhaqesh,  
Jetën sot kudo un' e kam parë,  
Ndaj dhe dua, këtu në mes vargjesh,  
Yjet t'i shpërthej si fishekzarë.

Do ta shkund si pluhur mospërfilljen  
Dhe stuhis' përpara do t'i dal,  
Njëqind vdekje s'ma rrëmbejn' besimin,  
Ktë besim çelik, në ideal.

Koha komunizmin do ta sjellë  
Përmbi supat tonë të djersitur,  
Me flamur të kuq do ta mbështjellë  
Gjithë botën brezi yn' i ndritur.

## E DUA GJELBËRIMIN TËND ATDHE

Një bisk ulliri dua të këput,  
E t'i prek njerëzit si me shkop magjik.  
Këtë gëzimin tim në shpirt t'u fut,  
S'ka gjë në do më quajn' romantik.

Jan' pjes' e vetes sime këto ara  
Ku rrot' e qerres gjurmën bukur lë,  
Bariu delet ku i vë përpara,  
E ku sulmojn' traktorët një nga një.

Ne si magnet na mbajnë këto toka,  
Të thella rrënje kemi tek ky dhe,  
I duam këto fusha të paana,  
E duam gjelbërimin tënd atdhe!

## TEK BARINJTE

Dridhen fytyrat në cipën e zjarrit,  
Fytyrat e barinjve gunahedhur krahëve,  
Biseda na rrëmben të gjithëve e përzëmërt,  
Mysafir jam sot këtyre anëve.

Këtu në Orosh yjet ndritin afër,  
Gjuha e erës lëpihet ndër pisha,  
Nië ujk ulërin tej i pakënaqur,  
Qëntë ngrehin lart turiçkat e hirta.

Në kasolle ndizen temat e kohës,  
Parreshtur dollitë ngrihen me radhë.  
S'ka gjë në rakia është e fçrtë,  
Me fund për Partinë pihet, mos djalë!

Rrukullisen orët në detin e natës,  
Nga flatrat e gjëra të këngëve  
Gjuhëzat e ziarrit luajn' paprerë  
Meloçinë e përflakur të zemrave.

Kështu me gunën e hedhur mbi supe  
Më zë gumi në mesnatën e vonë,  
Me mendimet më të mira të njeriut në kokë  
Dhe me ndjenjën e madhe të jetës gjoks.

## KĒNGĒ NĒ MUZG

Tenikët piketat vendosën atje,  
Ku nesér do tē lindë një vepér e re.  
Aroma e tokës kanaleve del  
Dhe era së largu një këngë na sjell.

Tē ardhmen e shohim tē bukur, tē qartë,  
Këtu do tē ngrihet oxhaku i lartë,  
N'uzinë maqinat me gaz do ushtojnë,  
Në punë sirenat puntorët do ftojnë.

Në tokat e thata ne djersën dc mbjellim,  
Kolona betoni si lule tē çelin  
Dhe dritat tē ndrisin me qindra e mijra  
Dhe zemrat tē rrabin tē forta, tē lira.

Këtu do tē ngremë ne ëndërrat tonë,  
Lastarë tē freskët tē pemve tē njoma,  
Dhe muskujt do ndrisin nën diellin e artë  
Mbi tokën e dashur, mbi tokën e zjarrtë.

O shok, kudo mbi tē shtrënjin atdhe,  
Shiko si po ngrihet e ardhmja tek ne.  
Me mua dhe ti këtë këngë këndo  
Dhe kazmën dhe pushkën më fort i shtrëngó.

## LETËR NJË SHOKU

Më kujtohet shpesh fytyra jote,  
Si një këng' e thjesht' e paharruar,  
Tok ja njohëm gazin kësaj bote  
Që at'here moteve të shkuar.

Kur lodronim fushave të qeshur,  
Kur pak vite kishim ne në jetë,  
Ti me afsh për detet flisnje dendur,  
Un' për fluturimet ndër planetë.

Ëndërronim jetë heroike,  
Ideal të lartë njerëzor,  
Dhe na ndriste shpesh fytyratëmbël  
Bukuri' e gazit fëminor.

Kurse sot mbi tokëzën e shtrenjtë,  
Ti në jugë, unë në veri,  
Shpatullat i vumë komunizmit,  
Të ndriçoj' e ardhmja me fuqi.

Do lundrojmë dhe në det të kaltër,  
Qiejve të paanë do lundrojmë,  
Porse sot ne këngën më të pastër  
Për atdhen' e dashur ta këndojojmë.

Këtu ka kaq vend pér heroizma, ,  
Jetë plot kuptim dhe madhështore.  
Me flamurin e kuq të së ardhmes  
Po sulmojmë të jetës aksione.

Ja pra, shok, u bë dëshira jonë  
Të jetojmë jetën e vërtetë,  
Pra, pranoji vargjet shkruar thjeshtë  
Tok me përqafimin e sinqertë.

## NË FAMILJE

Në dhomë është mbledhur familja e tërë;  
Kokulur, i skuqur unë rri,  
Mamaja dhe gjyshja gjith' vesh' janë bërë:  
Babai lexon poezi.

Në faqen letrare papritur ka ndeshur  
Babai dhe emërin tim,  
Këmbkryq mbi minderin rri gjyshi i qeshur,  
Mustaqen përdredh me gëzim.

Të gjith' po dëgjojnë; babai mbaroi;  
Mamaja më puth me rrëmbim,  
Dhe mendja e saja kushdi se ku shkoi,  
Kushdi si më pa n'ëndërrim.

T'u them që s'janë timet, kjo ësht'e kotë,  
C'e solla gazetën këtu!  
«Mor, mir'i ke shkruar» babai më thotë,  
Veç fundi nuk vete kështu».

«S'do zihemi më» — shpejt motrat më flasin,  
«Tani që u bëre poet,  
S'e kemi dëgjuar; poetët s'të ngasin,  
Të zihen s'iu ka më lezet».

Të gjithë më uruan; shakatë s'mbaruan,  
Po gjyshja ku vallë të jetë?  
Aha, e kuptova, kushdi se ç'gatuan,  
Për nipin e saja, poet.

\* \* \*

Në dhom' është mbledhur familja e tërë;  
Kokulur, i skuqur un' rri,  
Mamaja dhe gjyshja gjith' vesh janë bërë:  
Babai lexon poezi.

## KUR BINTE SHOKU...

Kur binte shoku ně luftim  
Me plumb'n e zi ně gjoks,  
Ja hapnin shokët me trishtim  
Të fundmin shtrat ně tokë.

Kur shoku binte, shokët shponin  
Një varr, me bajonetë,  
Aq cekët, sikur ata donin  
Më afër t'ish ně jetë.

Kur vdekja frymën do ma marrë,  
Kudo që të më zërë,  
Do desha veç të tillë varr  
Me bajonetë bërë.

\* \* \*

Lëviz stacionet;  
E shqetsuar bota

Shfryn në eter plot nerva e tension.  
Me sytë ngulur natës përtej xhamit,  
Mendoj: do shkojmë nesër në aksion.

Spikerët grijnë në gjuhë të ndryshme,  
Për bisedime, lüftë, yje kinemaje  
Dhe me fragmente xhazi i ilustrojnë.  
Lëviz stacionet,

Një rrugë në male  
Do nisemi nesër në aksion të ndërtojmë.

## PËRPARA JETËS

Kur në rrugë mbrëmja zë e bie,  
Fushave të gjera dal e rri...  
Ç'më pushtoi kjo flakë poezie.  
Në pranver' të jetës, në rini.

Dua që të jem ndër gjith' kantieret  
Veri-jugë mbi atdheun tim,  
Me çelikun do t'i shkrija vargjet  
Furrave të larta me gëzim.

Ne njëzetvjeçarët sypatrembur.  
Mjegullat i çajmë kohrave,  
Me guxim sulmojmë për të shembur  
Të fundit barriera përmbi dhe.

Me kaq vite vetëm parathënjen  
Ne i shkruam vetes përmbi botë,  
Veprat e vërteta po na presin  
Rrugëve të reja ne, o shokë.

Ja, pra, mik, jetojmë ne të lumtur,  
Frymë marrim avujve të djersës,  
Kudhrave, çekani ku irreh bukur,  
Ne ja ndjejmë poezinë jetës.

E megjithatë nuk jam i qetë,  
S'di se ç'zjarr më përvëlon në gji,  
Ndaj dua të jem ndër gjith' kantieret  
Mbi atdheun, n'jugë dhe veri.

Në agimet e reja që shkrepin  
Un' e di që e ardhmja thërret,  
Ndaj më djeg kjo flakë poezie,  
Kur kam mbushur pranvera njëzet,

## MES GRURIT

Bisedova për poezinë  
Me bujqër të mirë,  
Mes grurit të lartë në fermë.  
Përzihej me fjalët  
Nga era e prirë  
Fërshëllim' e kallinjve të verdhë.

«Patjetër, o mik, — më thanë ata —  
Patjetër do bëhesh poet,  
Gjersa kaq shumë i dashke ti njerëzit  
Dhe tokat e gjera si det.

Po vetëm lëruar do thellë poezia  
Dhe kënga do ndezur në flakë,  
Dhe vargjet mos jenë të thata, pa ndjenjë,  
Sikundër një tokë pa vlagë».

Bisedova për poezinë  
Me bujqër të mirë  
Mes grurit të lartë në fermë.  
T'u shtoj, u përpoqa,  
Ugareve të vargjeve  
Ugaret e grurit të verdhë.

## VARGJE PËR HEROIN VIETNAMEZ

Me ç'lajm të zi agimi sot na zgjoi  
E plumb të rëndë lotin lëshoi syri,  
Djaloshi vietnamez Ngujen Van Troi,  
Komet' e zjarrt', në mëndje tonë hyri.

Ndaj sonte gjithë ëndrrat i dëbova,  
Vështrimi tij aspak s'më lë të qetë,  
Atë porsi të gjallë e shikova  
Kur përmes plumbash kokën ngrij përpjetë

Ai nuk donte kurrë që një popull  
Të ishte kudhër e dikush çekan,  
Dhe ëndërronte ndoshta që orizi  
I lart' të rritej fushës në Vietnam.

Dhe s'kishte cilësi të jashzakonshme  
Dhe as shkëmbinj, si Herkul s'kishte shembur,  
Por kishte zotësinë më të madhe,  
Dinte të vdiste vdekjes pa iu trembur.

Ta kam zili guximin tënd, Ngujen,  
Në sy e pe ti vdekjen me përbuzje,  
Lavdia e mbuloi emrin tënd,  
Si bora e përjetshme Everestin.

Për ty i thura këto vargje, pra,  
Ndaj sonte gjithë ëndrrat i dëbova,  
Ndaj përmbi emrin tënd, Ngujen vëlla,  
Mbi emrin tënd për luftë u betova.

Se ne s'e duam botën të coptuar,  
S'lejojmë të të prekin ty, Vietnam,  
Ndaj mbi xhelatët janki, të tërbuar,  
Urrejtja jonë ngrihet uragan.

## SJELL NDËRMEND

Më vjen ndër mend gjithmon' një nat' e bukur:  
I arti plor i hënës çante qiellë,  
Si farë gruri, yjet ishin dukur,  
Që hidhte me grusht nata pa ndërprerë,

Përtej ndriçonin dritat e qytetit,  
Akoma pse s'më flihej nuk e di,  
Por kur shikoja botën kaq të madhe,  
Më kapte ngashërimi mu në gji.

Aher' m'u ndezën ëndërrat e para,  
Aher' e pashë veten time larg,  
Krenar ta hidhja çapin përbimi botë  
Dhe jetën gjith' ta shkri për ideal.

Dhe nuk e di sa zgjati ajo natë  
Plot drita nënë qiellin boj' mavi.  
Kur befas seç e ndesha poezinë,  
Si dashurin' e parë në rini.

Tetëmbëdhjet' akoma s'kisha mbushur  
Dhe melodja e jetës ndihet larg.  
A ish e mundur vallë, ish e mundur  
Që të mos thurja qoftë dhe një varg?

Më vjen ndër mend gjithmon' kjo nat' e bukur:  
I arti plor i hënës çante qielë,  
Si farë gruri yjet ishin dukur,  
Që mbillte me grusht nata pa ndërprerë,

## TANKSET

Ata kalojnë të rëndë, krenarë,  
Mbi supe kanë hedhur  
Pelerinën e gjelbër të pranverës;  
Gërvishtin zinxhirët  
Qetësinë dhe asfaltin.  
Admirojnë kalimin e tyre ca njerëz.

Rëndë lëkunden grykat e zjarrit;  
Teksa kolona kapërcen asfaltin,  
Ashtu vigjëlojnë  
Që nesër agresorit  
Me fjalën e fuqishme t'i flasin.

Të mahnitura, veturat  
Presin në rrugë  
Kalimin e kolosëve të gjelbër:  
Kërkëllijnë zinxhirët,  
Sikur bluajn' pa reshtur  
Kokallat e armiqve të përjetshëm

Buzëqeshin tankistët  
Mbi korracat e rënda  
Duke fshirë me mëngë djersën mbi ballë,  
Dhe kështu zhduken  
Në tymin e hirtë  
Admirimin tonë të singertë duke marrë.

## ÇAST DASHURIE

Ti buzëqeshje ëmbël që nga poshtë  
Me buzët ngijer manave të zinj,  
Un' sipër degëve shkundja me kaq forcë,  
Sikur të shkundja ty një qiell me yj.

Dhe përnjëherësh sytë tan' u ndeshën  
«Mos biesh» — ti më the ashtu plot gaz,  
Por më mahnitit bukuria jote  
Dhe keq më shkau këmba për një çast.

Dhe zëri yt q'e njoh mes mijra zërash,  
U derdh ather' në thirrjen aq të trembur:  
«Po zbrit, pra, zbrit» me sytë qortim mbushur  
Më the me dashuri ashtu e vrënjtur.

Por n'atë çast e kisha zemrën flakë  
Në krahët e së madhes dashuri,  
Prandaj i tundja degët prapë, prapë,  
Sikur të shkundja ty një qiell me yj.

## TRAKTORISTIT

Të shikova fushës, traktorist,  
Kur ja çaje tokës gjoksin thellë,  
Më shum' hapje brazda ti ndër plisa,  
Se sa koha ballit tënd kaq herë.

Koha mbetet prapa e kapitur  
Me traktor kur sulesh fushës ti,  
Sado brazda ballit të të çelë,  
Do të mbetesh përgjithmon' i ri.

Brazdave që hape, bim' e jetës,  
Gruri kallirëndë do të mbijë:  
Ne besimin nuk ja heqim vetes  
Për të bollshmet korrje që do vinë.

Ta punojmë tokën thellë, mirë,  
Që të vlojë sofrave gostia,  
Që të themi nesër pa u shtirë  
E përjetshme do të jet' liria.

Kështu ështëjeta, traktorist,  
Si një brazdë kohës që i hapim  
Po punuam mirë, traktorist,  
Gjelbërimin jetës ne i japim.

## USHTARI QË PËRJETËSISHT MBETI USHTAR

I çpleksi muzgu leshrat ngjyrë ari,  
Me lejë në shtëpi u nis ushtari.

Përmbi kamjonin, era lehtë-lehtë  
E puth, si nën' e dashur kur t'i vejë.

Por prapa seç gjëmoi horizonti,  
U hap mbi fushë era e barotit.

Ai shikon, kufiri digjet larg,  
Ju errën sytë me vetullat si hark.

Godet me grusht fuqishëm mbi kabinë  
— Shofer, shofer, po ndale pra maqinën!

Frenon maqina, ai humb në pluhur,  
Ku krismat e fuqishme grisën muzgun.

Dhe ngrihen predhat si mullarë flokësh,  
Kolliten mitralozët e përgjakshëm.

Në sulm të rreptë hidhen kufitarët  
Ja mbathin vrapi, fushës, palikarët.

Ndërsa ai si shkëmb qëndroi përjetë  
Përmbi kuotën që e mbrojti vetë.

Dhe era lapidarın ja puth sonte,  
Si nëna kur me leje do t'i shkonte.

Pér nē shtëpi, ushtarët ven' e vinë,  
Ndërsa ai një çast s'e le kufinë.

Kështu qëndron si karakoll krenar  
Ushtari, që përjetësish mbeti ushtar.

## NË MIRDITË

Pisha të larta  
Në sfondin e maleve,  
Si pikçuditse  
Në frazat e gjata të shekujve.  
Burra shtatlartë,  
Kokëlidhur  
Me shamitë e bardha të reve.

Tungjatjeta Mirditë,  
Beden nga bedenat  
E Shqipërisë,  
Më ushton krenare  
Kënga e përjetshme e trimërisë.

Tungjatjeta Mirditë!  
Ku erërat krihen  
Me krëhër borigash,  
Ku ngrihen mbi kullat  
Kooperativat.

Udha valvitet lartësive  
Nga zgresin «Shytat»  
Ngarkuar plot.  
Makina lundron në pelgjet

E hijeve,  
Kthesat mbajnë erë rrëshirë e ferodë<sup>1)</sup>

Tungjatjeta Mirditë!  
Ngjitem shkëmbinjve të thepisur  
Në Orosh,  
Më ravizohen ballit  
Rrudhat e burrërisë.  
Ndez një cigar në çakmakun e djellit,  
Tok me të thith me gjithë mushkëritë  
Prrenjt' e padukshëm të flladeve  
Dhe të qiejve kaltërsitë.

Tungjatjeta Mirditë!  
Ky pejsazh i ashpër,  
Plot konture malesh  
E reflekse ngjyrash të ndezura  
Më lëroi në tru brazdat e përjetësisë,  
Dhjetra kujtime e mbresa,  
që do t'i hedh  
Në vargje poezish të gjelbëra.

---

1) ferodat — disqet e frenave

## DOLLIA IME PËR VITIN E RI

Rreth vatrës shqiptare gjithë mbledhur,  
Kështu na gjeti ora dymbëdhjetë;  
U shtua dhe një vit në biografitë,  
Gëzimi ja bën' peshën më të lehtë.

I ngriten gotat shokët nëpër duar  
Nga jugu ynë deri në veri  
Dhe, kur më erdhi radha pér t'uruar,  
Me vargje thura un' këtë dolli:

«Ne jemi kolektiv i fortë, shokë,  
Në unitet e çajmë historinë,  
Ne jemi si barut i thatë, shokë,  
Që asnjëherë s'duron lagështinë.

Partia ësht' kapsollja që na ndez;  
Kur shkrep ajo, në zjarr hidhemi ne  
Që diejt' e komunizmit me miliona  
Si yj të vezullojnë mbi atdhe.

Le të na rrjedhin vitet si gjer sot  
Si hije kohën pas le ta térheqim  
Dhe kur t'na mbushen flokët thinja plot,  
Ndërtonjës t'komunizmit do të mbesim.

Ky emër ësht' i lartë dhe plot ndër,  
I mbjell kujtdo në zemër krenari,  
Gëzuar miq, gëzuar njëqind herë  
Na qoftë rrug' e mbar' e plot lavdi».

## PËR RININË TIME

Shpërtheu prej kantieresh,  
Shpërtheu prej ugaresh  
Edhe tek un' u shfaq një dit'rinia.  
Me muskujt e çeliktë,  
Dhe flakë idealesh,  
Saldova me guxim èndrrat e mia.

Në zjarrin e furishëm  
Të jetës madhështore,  
Një ur' e ndezur dua që të jem;  
Në murin e fuqishëm  
Të gjokseve puntore  
Në vend të sulmit, vendin do ta kem.

Për komunizmin. shokë,  
(E cilët nuk e dinë?)  
Kashtën e Kumtrit luajm' vendit ne,  
Dhe yjet si pishtarë  
I mbartim përmbi shpinë,  
Të vij e shumëpritur' bot'e re.

Kur diell' i komunizmit  
Do ndrisë përmbi tokë,  
Do jetë kjo m'e madhja lumtëri.

Aher' do jemi shumë,  
Me qindmilionë shokë  
Do përshëndesim këtë diell të ri.

Kështu në mes kantieresh,  
Kështu në mes ugaresh,  
Shpërtheu dhe m'u shfaq dikur rinia.  
Me muskujt e çeliktë  
Dhe flakë idealesh,  
Saldova un' aher' èndrrat e mia.

## MBRËMJE NË FUSHKRUJË

Arrita në Fushkrujë tok me mbrëmjen  
Në rrugët që s'e njohin qetësinë.  
Mbërtheu në të katër horizontet,  
Me gozhda yjesh, nata pelerinën.

Mijra maqina udhëtojnë sonte,  
Shkëlqejnë dritat jugë e veri;  
Janë ruazat e kuqe të gjakut  
Arterieve të tua, Shqipëri.

Fabrika e çimentos këtu pranë,  
Nga dritat si kështjellë prallash ndrit.  
O poezi industriale,  
Sa i fuqishëm qënka vargu yt!

Miliona mbrëmje do vin' e do ikin,  
Agime me miliona do shkreptinë...  
Sa lumtëri të rrish kështu ndaj nate,  
Të ëndërrrosh pas vitesh Shqipërinë.

\* \* \*

Piva gjithë prrenjve të Kelmendit  
Më mahnitën malet kryelartë  
Më pikuan vargjet tok me djersën  
Të përpjetat kur i ngjitja vrap.

«Eh, sa pak të njohim, Shqipëri»,  
Themi kur kalojmë ndër krahina,  
C'qetësi të shpirtit na jep tí,  
Gurgullim' e prrenjve ndër lugina.

Zbrisni, ujëvara madhështore,  
Lartësohuni, bedene malesh,  
Bukuri e tokës kaq të shtrënjtë,  
Për një çast m'u shfaqe midis vargjesh.

S'ka në botë kombinim të tillë,  
Madhështi me bukurin' e egër.  
Kur kaloj n'luginat që s'kam shkelur,  
Ndjej se po zbuloj një botë tjetër.

Dhe këtu që nga Vermosh' i largët,  
Gjithë hapësirat i përpi  
Dhe mendoj mes pulsesh krenarie:  
«Eh, sa pak të njohim, Shqipëri».

## NËPËR MALLAKASTËR

Këtu netëve paska kaq yje  
Dhe maleve kaq borë përreth.  
Hëna dritën e zbehtë na bie,  
Këngën lehtë veriu e dredh.

Mallakastra e regjur në luftë,  
Përmbi shpate po mban miq të rinj.  
Nëpër shtigje fener i xha Rrapos  
Porsi zemër e Dankos na prin.

Mbi një breg ky xha Rrapua qëndroi:  
«Djema, dua një këngë nga ju ,  
Që gjith' fshatrat këtej ta dëgjojnë  
Se jan' djemt' e Partisë këtu.»

Si nuk mundemi ne, o xha Rrapo,  
Të këndojm' pér të shtrënjen Parti?  
Ja, i mbushëm ne gjokset me ajër  
Dhe shpërthyem në qiell pa kufi.

Eh, sa bukur kumboi kjo. këngë!  
Heshtën lehjet e qënve përtej.  
Un' kaloj midis vargut të shokve  
Dhe një lodhje të këndëshme ndjej.

Ç'lumtëri të kalosh këto vende,  
Me kaq njerëz të mirë të jesh,  
Dhe mikpritjen e ngrohtë fshatare  
Si një gunë mbi supe ta kesh.

## BALADË

Dimri jashtë qan,  
Hingëllin si kalë,  
Nënës, kapedan,  
Si s'i flet një fjalë?!

Mu në mes të luftës  
Shokët seç i le,  
Korbave dhe turqve  
Ua bëre pre.

Sa e sa her' turqit,  
S'i vure në sy;  
Vall ç'menduan shokët,  
Kapedan, për ty?

Dimri jashtë derës,  
Mbi qefin të natës,  
Fshikullim' e erës  
Seç i ngjaka shpatës.

Dyerve tufani  
Si njeri rënkon,  
Zbehur kapedani,  
Shokët i kujton.

Kapedan, s'durove,  
Dole gjokszbuluar,  
Kalin e shalove,  
Pallën mban në duar.

Gjurmët prap mbetën,  
Herët në agim,  
Mbi dëbor' e gjetën  
Të ngrirë një trim.

## NË KRUJË

Me hov i merr maqina të përpjatat  
Dhe ja ku duket Kruja legjendare  
Në muret e kështjellës së pamposhtur,  
Ndriçon lavdi e lashtë qindvjeçare.

Të përshëndes, Sari-Salltëk i thinjur,  
Përulem para teje, Kastrict.  
Si bij besnik' t'i ruajtëm traditat  
Dhe s'jemi më pak trima neve sot.

Ky vend, ku sokëllinin dikur malet,  
Ku sot më dysh ndan retë shpat' e Tij,  
Na bën t'i shohim më të pjekur' ngjarjet  
Ne njerëzit e brezave të rinj.

Qëndroj këtu mbi tokën virgjëreshë  
Dhe krah u jap mendimeve të mia  
Dhe jam krenar, o miq, për krenarinë,  
Që, e përligj e gjithë historia.

## SI FANAR PËR POPUJT

Ja kushtoj heroit vietnamez Ngujen Van Be,  
që hodhi në erë veten dhe agresorët.

Më shfaqet dendur buzëqeshja jote  
Si trandafil i viteve rinore,  
Ti mbete i përjetshëm, Ngujen Van Be,  
Në librin e lavdishëm të heronjve;

Ish e fuqishme mina që ti plase,  
Por urrejtja jote ish më e fuqishme,  
Ajo i vau jankit, Ngujen Van Be,  
Armiqtë gjakpirës me fytyrë bishe.

Ti ngrite minën dhe urrejtjen e madhe,  
Njëzet vitet e tu qen' njëzet ton triolit:  
Grataçielët e Uoll-Stritit u lëkundën me radhë,  
Bota heroizmin tënd dëgjoi.

Ti shkove drejt sakrificës supreme,  
I dashur, i thjeshtë, me zemrën e bardhë,  
Dhe kishin aq shkëlqim syt' e tu atë çast,  
Sikur po shkoje në takimin e parë,

Kështu u ngulite në sytë tanë,  
Ndriçuar nga aurela e heroizmit të madh.  
Në detin e dekadave dhe shekujve,  
Për anijet e popujve mbete fanar.

## NJË LETËR

Era përjashta çirret, e rrëptë;  
Vëlla, kjo letër s'qenka e lehtë...

Përreth tryezës gjithë menduam,  
Nënës së shokut letër i shkruam.

Natën që shkoi e gjetëm vrarë,  
Mes për mes gjoksit plumbin kish marrë.

E aty pranë shtrirë qëndronin  
Dy diversantë, dheun kafshonin.

Era përjashta çirret e rrëptë,  
Vëlla, kjo letër s'qenka e lehtë...

Edhe postieri zor do ta ketë,  
Letra në çantë plumb do t'i jetë.

Gjith' ndaj atdheut për nder e kemi  
Të japim jetën, gati ne jemi.

Por sot të gjithë shokët e postës  
Sikur po mbajmë hallet e botës,

Gjokset na djegin lotët e shkretë,  
Vëlla, kjo letër s'qenka e lehtë.

## BALADË PARTIZANE

Me zor mundohej t'i përmbante dhëmbjet  
Kur po e çonin shokët me barelë  
Dhe për të fundmen herë buzëqeshi:  
«O shokë, — tha, — ja merrni dhe një herë».

Gjëmoi kënga shtigjesh e fuqishme  
Dhe u përplas shkëmbinjve anëmbanë;  
Kushdi të satën herë e këndonin,  
At' këngë që po mbante shokun gjallë.

Ai shikoi shokët, hapësirat,  
Dhe fluturoi malesh me jehonën;  
Kur shokët heshtën, dhe ai kish heshtur,  
Në këngë ishte kthyer përgjithmonë.

Me sytë mbushur lot, por zemrat hekur,  
Ata vazhduan rrugën me barelë  
Edhe iu dukej prapë se do thoshte:  
«O shokëni, ja merrni dhe një herë».

Dhe, pa i thënë fjalë njëri tjetrit,  
Njëherësh katër gjokse shkrepëtinë.  
Ai i vdekur sikur buzëqeshte,  
Shkëlqim i jepte yllit mbi bustinë.

## PËRPARA NJË FËMIJE

Shikoje qiellin, vogëlush,  
Shikoje sa i kaltër;  
Me dritë dielli seç i mbush  
Dy syt' e tu të pastër;

Shikoje qiellin, dhe në mend,  
Përherë ta mbash mirë:  
Ka derdhur gjak babai tënd  
Që ti të rrrosh i lirë.

Ti ndoshta fare nuk e di,  
Ndër mend s'të shkon mendimi  
Se vende ka ku djem, si ti,  
Nga gjumi i zgjon gjëmimi.

Do t'i ndjesh jetës shum' gëzime  
Dhe, kur të rritesht ti,  
Si trim t'i mbrosh këto hapsira  
Në jug' e në veri.

Por veç një gjë ti mbaje mend,  
Ndaj të luftosh në jetë,  
Që pastërtin' e qiellit tënd  
Ta shtrish përmbi planet,

Që bukurin' e jetës sonë  
Mos na i prekin kurrë;  
Ndaj do luftosh ti, vogëlush,  
Kur nesër të jesh burrë.

## NË BREGUN E DRINIT

Kaloja një ditë

në bregun  
e Drinit

Me flokët që era

m'i krihte  
po reshtur;

Nuk mburrem që shumë

kam ecur  
mbi botë

Dhe vende pa numër

kam shkelur.

Dhe sot përmbi shkrepat

e egër  
qëndroj,

Habitur nga pamja

kam ngelur;

I lumtur poeti

që shpreh  
me një varg

Buzqeshjen e madhe

të tokës

së gjallë.

Këtu do të ngrihet

një hidroçentral,

Si diell i ri  
mbi vendin  
e lashtë,  
Mbi nulla malsorësh  
do ndritë,  
o shokë,  
Ai do të jetë  
për paditurinë  
Skuadr' e pushkatimit  
përmbi  
këtë tokë.  
M'u duk se gjith' botë  
ecën  
Kalojmë në revistë  
veprat  
krah meje,  
Nga gjoksi, furishëm  
madhështore...  
Shkëmbinjt' e pasuan  
shpërtheu  
një këngë,  
me mijëra kore.

## TUNGJATJETA ADRIATIK

Tungjatjeta Adriatik,  
Përkëdhel me radhë kreshtat e valëve  
Si rrudhat e gjyshit, dora e nipit.  
Lëkundem në masën e gjelbër, vigane,  
Më mbulojnë stërkalat  
E ujit dhe mendimit.  
Më habit pafundësia jote, det,  
Më kthjellohet mendja,  
Më gjelbërojnë ndjenjat.  
Me forcë zemra,  
Shtëllungat e gjakut hedh në aortë,  
Rrëshqasin mendimet  
Binarëve të vargjeve,  
Si pulëbardha përhapen mbi botë.  
Dashuroj dashurinë  
Dhe jetën e hareshme,  
Jam një akord modest  
Në simfoninë e madhe njerëzore.  
Notoj mes mirazhezh,  
Mes ylberësh e rubinësh të ndezur,  
Nën kurorën e përflakur diellore.  
Futem në arenën e madhe të jetës,  
Ku kurrë veten  
S'e ndjeva të tepërt.  
O botë e lumtur njerzish të qeshur,  
Më madhështore se madhështi e deteve!

## MIQVE TË BOTËS

Un' kam miliona miq kudo në botë,  
Nga lindj'e largët gjer në perëndim,  
Për ta nga shkëmb'i shqipeve ngre gotën,  
Për ta që aq të shtrenjtë kan' lirinë.

Të bardhë jan', të verdhë a zezakë,  
Por që të gjithë trima dhe heronj  
Llogoret ruajn', a në barrikadë,  
A partizanë malesh, vigjëlojn'.

Dhe vit' i ri disa i zë në luftë,  
Me syrin në shënjestër ca të tjerë,  
Dhe të përgjakshmet faqe të lavdishme  
I shtohen historisë pa ndërprerë.

Cdo vit që vjen, na çon gjithmon' më pranë  
Drejt idealit tonë madhështor.  
Dëgjoni si buçasin sot trumbetat,  
Që ndezin zjarr guximin burrëror.

Ndaj në të shkurtin çast, kur ndrrohen vitet,  
Ju përshëndes, o miq kudo mbi botë,  
Drejt rrugës së vështirë të së ardhmes,  
Falang' solide, të marshojmë, shokë.

## BREZAVE QË VIJNË

Dëgjoni, gjenerata, zërin tonë,  
Të brezit dekoruar me lavdi.  
Për neve ndoshta nesër do të thonë  
Me mijra fjalë, lavde, poezi.

Por neve kemi bërë veç detyrën  
Në emër të së ardhmes madhështore;  
Çdo gjë që sheh këtu përreth, e ngritëm,  
Me forcën e pamposhtur njerëzore.

Uzinat dhe pallatet kryelartë  
I pagëzuam në lumenjt' e djersës,  
Në farkën e përditshme rrezezjarrtë;  
Kuptimin e vërtet' i njohëm jetës.

Ne po ndërtojmë madhështoren urë,  
Që nesër do na shpjer' në komunizëm  
Dhe u betuam mos ndalemi kurrë,  
Në sulmet që me trimëri i nisëm.

Këtu zë fill dhe dashuria jonë,  
Hedh rrënje tëndrra jonë më e bukur:  
Ta hapim flakën tonë nëpër botë  
Asaj çdo gjë të dëmshme për t'ja zhdukur.

Dëgjoni, gjenerata, zërin tonë,  
Prej resh stafetën nesër kur të merrni  
Nga ne do trashëgoni vrullin tonë  
Drejt fronteve të fundit kur të veni.

## DUKE SHKUAR NË BIGËN E MADHE

Mbrëmë u bëmë të gjithë

Poetë

Duke shkuar në bigën e madhe;

Me gjithë madhështinë

Na hapet kjo jetë,

Kur rrugën na ndritin

Të zjarra ideale.

Duke shkuar në bigën e madhe

Me mijra yj digjeshin mbi ne;

Ndjenim frymëmarrjen tënde gjigante

Dhe veten e ndjenim të fortë, atdhe.

Njerzit dikur shkonin në Mekë

Të merrnin bekimin nga guri i shenjtë,

Ne vimë këtu në bigën e madhe

Të njihem me ty,

O shok i shtrenjtë.

S'vijmë si shtegtarë të zymtë

Mesjetarë,

Për hir të fesë a besimit,

Por vijmë që veten ta ndjejmë

Krenarë,  
Të ndezim në zemër  
Të madhin pishtar frymëzimi.

\* \* \*

Ish një mëngjes  
Kur dëgjuam për ty,  
Për betejën e madhe të asaj nate...,  
Oxhaqet të qetë nxirrnin  
Tymin e zi  
Rrotat e maqinave suleshin asfalteve.

Dielli rrahu krahët  
Si pulbardh' e përgjakur  
Dhe i vuri veshin këngës së valëve.  
Deti brenda një nate sa shumë ishte plakur  
Dhe pëshpëriste emrin tënd  
Midis dallgëve.

Koha i kish ulur nervat atë çast  
Midis tisit të mjegullës,  
Me argjënd hapësirat ngjyente agimi,  
Ca re puplore shpaloseshin larg  
Si flamur i bardhë,  
Si flamur dorzimi.

Ti e nxore zemrën si pishtar,  
Flakën i vure Kashtës së Kumtrit  
Dhe, duke shkuar drejt përjetësisë,  
Njerëzve të qetë  
U rrëmbeve gjumin.

Ti hipe në një lartësi të madhe,  
Nga ku je i dukshëm

Për të gjitha kohrat,  
Nga biga lundruese, përmendorja jote  
Kujtimin më të bukur  
Unë përjetë mora.

\* \* \*

Në portin e Durrësit  
Ditët rrjedhin të shpejta,  
S'reshthin këngët e detit dhe këngët e njerëzve,  
Sirenat e anijeve  
Për ty ushtojnë të shpeshta  
Duke të gdhendur lavdinë e përjetshme.

Kështu, Adem,  
Ti prapë je me ne,  
Si distinktiv mbi zemrat u mbërtheve  
Dhe të shikojmë  
Të çash drejt së ardhmes  
Me shokët që aq fort i deshe.

Në apelin e madh të komunizmit  
Emrat tuaj, o heronj,  
Do thirren të parët;  
Do përgjigjet për ty biga e madhe  
Me zërin e fuqishëm  
Si ushtarët.

Mbrëmë u bëmë të gjithë  
Poetë  
Duke shkuar në bigën e madhe;  
Me gjithë madhështinë  
Na hapet kjo jetë,  
Kur rrugën na ndritin  
Të zjarrta ideale.

## PËR KALORËSIT E DETIT

Le të ngjiten dallgët përmbi bashin,  
Deti vë në provë trimërinë.  
Këto vargje sot ty të përkasin,  
Marinar, burim për poezinë.

Kur lundrojmë deteve të kaltër,  
Dashurinë marrim, o atdhe,  
Dashuria jonë ësht' e pastër  
Ndaj më gjoks tallazet çajmë ne.

Erërat detare e shpalosin  
Flamurin e flotës mbi direk,  
Perëndimet detin e ngjyrosin  
Me të murmen ngjyrë gjer në breg.

Dhe athere ndizet prozhektori  
Sy i zjarrtë terrin zë të shpojë,  
Ne qëndrojm' pran topave të heshtur,  
Që i pastër deti të këndojet.

\* \* \*

Përsëri agimet rreze derdhin,  
Pulëbardha shkumën zë e prek  
Dhe për ne, kalorësit e detit,  
Mijra zemra rrabin sot në breg.

## NGA LIMANI DOLI NJË ANIJE

Nga limani doli një anije,  
Farin vezullues e la pas,  
Midis dallgësh era zë e bie  
Melodin' e këngëve plot gaz.

Po këndoja' detarët ushtarakë  
Këngën luftarake me gëzim,  
Ndërsa hapësirat digjet flakë  
Tutje, atje tej në perëndim.

Mbrëmja zbret e bukur përmbi detin,  
Nata velin valëve e shtrin,  
Mbi kuvert' detarët përshëndetin  
Bregun që nga mijra drita ndrin.

Mos përgjo më kot, armik, mbas dallgësh,  
Ujrat po na ndyve, s'ke shpëtim:  
Vigjëlon në dete shqipëtare  
Luftarakja flot' e vendit tim.

Melodinë era zë e bie,  
Ekuipazhi këngë po këndon,  
Nga limani doli një anije,  
Që atdheut roje i qëndron.

## **DETARËVE TË NËNDETIT**

Nëndetsja i çan ujrat si peshk luspaçeliktë,  
Detarët vigjëlojnë në postet luftarake  
S'i përkëdhel ata as flladi i mendafshëtë  
Dhe shpesh s'kan' dhuratë të diellit rrezet bakër.

Ndërsa pushojnë njerzit në bregun me ranishtë  
Dhe vrullshëm frymëzimin ja nxit vala poëtit,  
Me duart e çelikta drejtojnë aparatet  
Heronjt' e thellësive, detarët e nëndetit.

Prandaj mos e shih detin, poet, si romantik  
Dhe mos e fillo këngën me vargun e brilantë:  
«Mbi detin mjekërbardhë asgjë nuk pipëtin,  
Dhe me tantella valësh krahët qëndis një çajkë».

Pa nguli sytë mirë tej ujrave të gjelbra:  
Një vazhd' e bardhë shkume me shpejtësi vrapon,  
Lëshon diku reflekse çelik' i periskopit,  
Prandaj e pastër vala pas bregut po ushton.

## O JU QË LUNDRONI

Nga deti po ngrihet spiranca ngadalë  
Dhe urdhri u dha për lundrim,  
Gatituni, shokë, anija do dalë  
Në detin ku nata po nxin.

Mbi urë-komandën u ngjit kapiteni,  
Bustinën mbi kokë e ngjesh  
Dhe kokën e kthen nga dritar' e bregdetit.  
E dashura grua ku pret.

Gumzhijnë fuqishëm motorët në çast;  
Nga baza anija po del  
Në tylin e natës dhe këngën e valës,  
Me afsh, deti plak e mbështjell.

O ju që lundroni syzjarr nëpër netë,  
Që kush mos na prekë në botë,  
Dhe këngëzën time, me vargje të thjeshta  
Shpalosni si flamur mbi bord.

## VARGJE PËR SNAJPERIN SYZJARR

1

Nga vargjet sot dua  
Të jet' vargu im rrufe  
në shtrëngatë,  
Nga zërat sot dua  
Të jet' zëri im m'i fortë,  
m'i lartë.  
Një kënge t'ja them  
Për mitingun e madh  
në Tiranë.  
Ka ngjarje që shuhen nga mendja si gjurmët  
në breg.  
Nga valët, nga shkumët e bardha.

Tatuazhe tē tjerat  
stampohen  
Në gjoksin pēr jetē  
e kohēs  
Por unē jo, kurrē tē gjalla.  
s'do harroj  
Kur shoku Enver atē çast,  
nē ballkon madhēshtor  
Dorën shtriu, doli lart.  
Flamur shpalosi  
n'qiellin  
Nga kupa e qiellit, e flaktē.  
miliona  
Pērshēndetēn festēn yj ranē,  
miliona  
Atē çast u ndjeva fishekzarē.  
brinjēve  
Fjalorēve atē çast ngushtēsinē,  
u njoha  
Mes flamujsh valvitur varfērinē.  
Nga era tē prirē

Dhe dritash që ndritin

me gjith'

madhështinë,

E pashë,

o shokë,

PARTINË.

2

Në djall këng' e lehtë

Me vargje

të but'

delikate,

Sot dua që vargu

nga zemra

të dalë,

Siç nxirret

në sulm

një granatë,

Dhe kënga

plot zjarr

si barut

të jetë,

Si vij' e Partisë,

e ashpër,

ë drejtë.

Fjalët e mia s'janë

shatërvan

magjepsës,

S'janë si fletët

që bien

vjeshtë.

Hapmani zemrën,  
shikojeni  
vetë,  
Gjakun e kuq  
si e Partisë  
biletë.

3

Si ta formoj  
portretin tënd,  
Parti?  
E pafuqishme  
fjala  
do të ishte;  
Kështu e thjeshtë,  
e dashur  
hyre ti  
Në këngët e rinisë  
Dhe këngët  
pleqërishte.  
Duke fluturuar  
me flatra  
entuziazmi,  
Mos e kërko  
Partinë,  
poet,  
Majë  
banderolave,  
pankartave;  
Partia është shkrirë,  
si kripa  
në det,

Në gjirin oqean të masave.  
Parti do të thotë rini e përjetshme,  
Çimento që betonon stuhi revolucionesh.  
Partia i bën njerëzit tē fortë si shkëmbinj  
Dhe shkëmbinjtë i kthen në toka pjellore.  
Ajo është snajper syzjarr i tradhëtisë,  
Esht' grushti çelik, që armikun dërmon,  
Esht' dor'e sigurtë, që nga goj' e Atdheut  
Dhëmballën e burokracisë  
Të krimbur e shkul, shkatërron,  
Esht' mijëra yj përmbi lapidarë,  
Esht' mijëra të rënë e mijëra tē gjallë;

Prapambetje, blokada

në hon

i vërvit

Dhe carët e rinq,

lakenjt

e pështirë,

Me vulën e turpit

damkosi

në ballë.

Partia, shqiponja

e qiejve

të lirë,

Anije

që kurrë

s'drejfon, <sup>1)</sup>

Partia me ne

dhe ne

me Partinë

S'ka forcë

që ne

na ndalon.

4

Ne ishim si tokat

Që kohrat

djerrë

i lanë.

Të metat Partia

si cungjet

na i shkuli.

---

1) Drejfon — kur anija shmanget nga kursi për shkak  
të rrymave dhe erërave.

I hodhi mënjanë;  
Traktorët e kuq      të ideve  
Mendimet e mykyra      çanë,  
Ndaj jemi të fortë,      Ndaj jemi  
                                si shkëmb  
                                në shtrëngatë.  
  
Partia,  
Si bujk i mësuar,      i regjur,  
                                i mirë,  
Kultivon dinjitetet,      vullnetet  
                                e hekurt,  
Kudo, në çdo tokë,      në çdo  
                                shkretëtirë.  
Kokrriza, të vogla      të botës  
                                së madhe  
Do ishim, o miq,      pa Partinë.  
Zotrinj luftënxitës,      që të  
                                mos gaboni,  
T'mos bëni      hesap  
                                pa hanxhinë,  
Për ne statistikat,      kur ju  
                                të shfletoni,

Lexoni:

dymilion plus Partinë.  
Esht' forc' e pamposhtur,  
e madhe pa masë,  
E mpleksur prej gjokseve tanë.  
Kudo, në çdo luftë, atë  
Si tokën Anteu komunistët  
e kanë.

5

Flet shoku Enver  
në ballkon atje lart.  
Çdo fjälë  
të tij  
Dhe ndjejmë se dita e përpajmë  
Kur si ne do bëhet e lumtur  
s'ësht' larg,  
Duart shtrëngojmë kjo botë  
me miqtë e gjithë.  
Nuk njeh miqësia distanc',  
tanë.

oceanë.

Popujt tē tmerrshäm

grushtet i kanë.

Kapitalistët, në fund

tē detit

Frymën ta mbajnë:

Kjo botë pér ta

s'ka vend

aspakë.

Kufit' do t'i shkulim,

o shokë,

një ditë

Si pejza tē kalbura

tē tē vjetrave

plagë.

Komunizmi si dielli

horizontit

do ndritë,

Kjo ditë do vijë,

nuk është,

jo, larg.

6

Por sot

Trumbeta e sulmit

ushton

përmbi botë.

Dadua revizioniste

bashkekzistencën,

Prrallën

bajate

na thotë,

Stacione sizmike

Tërmete

popujsh

registrojnë.

«Proletarë, bashkohuni»

ja parulla

jonë

Që fëmija gjumin

i qetë

të flerë,

Që paqja mos jetë

Një plaçkë

tregu

pa vlerë.

Gjaku vërshon

ndër rremba

i flaktë,

Urrejtja ndizet

si pyll

i thatë,

Për kauzën tonë,

idenë

e lartë,

Përpara,

o shok,

në armatë.

7

S'kisha parë

Të ndizej

kështu

entuziazmi.

Shikoni si qesh

e popullit zemra,

Hej, Kashta e Kumtrit  
po digjet  
në flakë,  
Ndriçohen me radhë  
hapësirat  
e gjera!  
Përreth prozhektorët,  
si sy  
ciklopësh,  
Montohen  
në qìell  
si bulona  
Që qìelli mos bjerë  
nga kënga  
e zjarrtë,  
Nga flaka  
e ndjenjave  
tona.  
Duartrokitja si llavë  
shpërthen  
anembanë:  
Pérshëndesin festën  
miliona  
fishekzarë.  
Un' kurrë në jetë  
s'do harroj  
atë çast  
Kur shoku Enver madhështor,  
në ballkon  
doli lart,  
Dorën shtriu,  
Flamur shpalosi  
n'qiellin  
e flaktë.

Nga kupa e qiellit  
miliona yj ranë,  
Në djall këng' e lehtë  
Me vargje të but',  
Sot dua që vargu delikate,  
ngā zëmra tē dalë,  
Siç nxirret nē sulm  
Dhe kënga plot zjarr një granatë  
Si vij' e Partisë, si baruti  
e ashpér, tē jetë,  
e drejtë.

## PASQYRA E LËNDËS

	faqe
Vargjeve .....	5
<b>KËNGËT E AKSIONEVE .....</b>	
Mirupafshim .....	6
Përshëndetje shokëve .....	7
Kënga e mëngjeseve .....	8
Krenari .....	9
O kodra .....	10
Gjith' e duan komandantin .....	11
Përshëndetje .....	13
Shokut të largët .....	14
Këndo, poet! .....	15
Vargje krenare .....	17
Mirupafshim, o vënde të shtrenjta .....	18
Kthim krenar .....	19
<b>KËNGËT E RRUGËS .....</b>	
Rrugët .....	21
Në autobus .....	23
Motiv studentesk .....	24
Një vajze .....	25
Poema e bukës .....	26
Për miqësinë .....	27
Fjala ime .....	28
E dua gjelbërimin tënd atdhe .....	29
Tek barinjtë .....	30
Këngë në muzg .....	31
Letër një shoku .....	32
Në familje .....	33
	35